



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 119

Tiranë – E premte, 23 gusht 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11259, datë 20.8.2019	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 8823
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 593, datë 1.8.2019	Mbi zbatimin e vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar..... 8823
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 594, datë 1.8.2019	Mbi zbatimin e vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar..... 8824
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 595, datë 1.8.2019	Mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar..... 8824
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 596, datë 1.8.2019	Mbi përcaktimin e masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal..... 8825

**DEKRET**

Nr. 11259, datë 20.8.2019

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Denis Besnik Barbullushi
2. Taulant Feim Çarciu (Carcu)
3. Majlinda Abdulla Hoxha (Hoffmann)
4. Firale Dane Ismaili (Kuqo)
5. Biljana (Ardita) Sllobodan Gorović (Matanović)
6. Ervin Nazmi Bregasi
7. Mario Isuf Ibrahim
8. Pamela Pëllumb Spahiu (Dyrmishi)
9. Milka (Millojka) Bozho (Zef) Bašanović (Bashanović/Kerstoj)
10. Shpresa Xhelo Tozaj (Çela)
11. Jaqueline Jetnor Dushku (Karam)
12. Eldina Lavdrim Osmani
13. Xherard Hazi Kurti
14. Alex Sotiraki Chatzini (Hatzis)
15. Elvis Ali Vajushi
16. Artemis Arqile Nesturi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

UDHËZIM

Nr. 593, datë 1.8.2019

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 31,
DATË 20.1.2001, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRFITIMET NGA
STATUSI I INVALIDIT,
PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK”,
TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, të pikës 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 10.653 (dhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj.

2. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 11.190 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2019 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2019, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Udhëzimi nr. 625, datë 27.8.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2019.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**



UDHËZIM

Nr. 594, datë 1.8.2019

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618,
DATË 7.9.2006, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT
DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË
PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI
TË KUFIZUAR”, TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, të pikës 27, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM-së, nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.653 (dhjetëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM-së nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.653 (dhjetëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 11.190 (njëmbëdhjetëmijë e njëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj për kujdestarin.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2019 dhe përballohen me fondet akorduara për vitin 2019, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Udhëzimi nr. 626, datë 27.8.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2019.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

UDHËZIM

Nr. 595, datë 1.8.2019

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 277,
DATË 18.6.1997, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRFITIMET NGA
STATUSI I TË VERBRIT”,
TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, të pikës 16, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, bëhet 12.092 (dymbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.

2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2019 dhe përballohen me fondet akorduara për vitin 2019, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

3. Udhëzimi nr. 627, datë 27.8.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2019.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu



UDHËZIM
Nr. 596, datë 1.8.2019

**MBI PËRCAKTIMIN E MASËS PËR
PËRFITIMIN E PAGESËS SË AFTËSISË
SË KUFIZUAR E TË NDIHMËSIT
PERSONAL**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, nenit 42/3, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, pikave 2, 3, 16 dhe 17, të kreut IV të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pjesa bazë për shkak të aftësisë së kufizuar, e përcaktuar në pikën 2, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, është 10,871 (dhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një) lekë në muaj.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 germa “a”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për personat mbi 18 vjeç, është 6,523 (gjashtë mijë e pesëqind e njëzet e tre) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

3. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 germa “b”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për personat mbi 18 vjeç, është 8,697 (tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

4. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 germa “c”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për personat mbi 18 vjeç, është 10,871 (dhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

5. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 germa “ç”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për

personat mbi 18 vjeç, është 13,045 (trembëdhjetë mijë e dyzet e pesë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

6. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 germa “d”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për fëmijët, është 4,892 (katërmijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

7. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa “dh”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për fëmijët, është 6,523 (gjashtë mijë e pesëqind e njëzet e tre) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

8. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 germa “e”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për fëmijët, është 8,153 (tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

9. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 germa “ë”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për fëmijët, është 9,785 (nëntë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

10. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 16, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për shërbimet gjithëpërfshirëse të ndihmësit personal, është 13,045 (trembëdhjetë mijë e dyzet e pesë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

11. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 17, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për shërbimet e herëpashershme të ndihmësit personal, është 8,697 (tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

12. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2019 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin



2019, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

13. Udhëzimi nr. 629, datë 27.8.2018, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2019.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë